



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.Shk II.nr. 1417/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-** Departamenti për Çështje Ekomomike-Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit N.N.T “Shkodrani” me nr. unik identifikues 811244186, me seli në Klinë, fshati Qabiq, me pronar R.G., kundër debitorit Komuna e Malishevës – Drejtoria për Infrastrukturë me seli në Malishevë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekomomike, KPPP.nr.790/22, i datës 30.06.2021, me datë 05.03.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Malishevës - Drejtoria për Infrastrukturë me seli në Malishevë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekomomike, KPPP.nr.790/22, i datës 30.06.2021, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekomomike, KPPP.nr.790/22, i datës 30.06.2021, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar prapësimin e debitorit Komuna e Malishevës i paraqitur ndaj urdhrin për përmbartim P.nr.319/21 i datës 08.06.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të prishet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekomomike, KPPP.nr.790/22, i datës 30.06.2021

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.N.T “Shkodrani” me seli në Klinë, fshati Qabiq, me numër unik 811244186 me dt. 08.06.2021 lëshuar urdhrin P.nr. 319/2021 me të cilin ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit faturë nr. 12/20 e datës 02.11.2020, duke

urdhëruar debitorin që në emër të borxhit për shkak të garancionit prej 10% në realizimin e projektit: Asfaltimi i rrugëve në fshatrat e Malishevës në pjesë pjesë – Loti 1, t'ia paguaj shumën prej 18,625.99 EUR (tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë euro, e nëntëdhjetë e nëntë euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga arritja për pagesë e faturës e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore për aq sa do të krijohen përgjatë procedurës.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbartimor, me arsyetimin se debitori, faturën në fjalë e ka dërguar për ekzekutim tek thesari në Ministrinë e Financave, por që thesari nuk e ka ekzekutuar pagesën me arsyetimin se kontrata ka qenë lidhur me afat prej 03.09.2019 e deri më 18.11.2020 ndërsa fatura është lëshuar pasi ka kaluar afati ligjor i kontratës, andaj nuk i ka plotësuar kushtet për pagesë. Ka shtuar se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një procedurë përmbartimore dhe se sipas nenit 29 të LPP-së fatura nuk është dokument i përmbartueshëm në këtë rast. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor. Kreditori në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke shtuar se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi i plotëson kushtet për lejimin e përmbartimit dhe e njëjta është pranuar nga debitori me datë 02.11.2020 duke u nënshkruar nga shërbyesi civil i debitorit dhe duke u vulosur me vulë të protokollit. Ka shtuar se pretendimi i debitorit se fatura nuk është paguar nga thesari nuk ka ndikim në këtë çështje pasi që fatura në fjalë nuk është ekzekutuar në procedurë administrative, ndërsa në procedurë përmbartimore, organi përmbartues i nënshtrohet rigorozitetit formal andaj nuk ka tagër që të vlerësoj ligjshmërinë e faturës por përshtatshmërinë e saj. I ka propozuar Gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit ndërsa Urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Shkalla e parë, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Shkalla e parë në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 12/20 e datës 02.11.2020 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi si dhe fatura në fjalë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë dhe nga vula e protokollit të pranimit nr. 03/2489 e datës 02.11.2020.

Tutje, Gjykata e Shkallës së Parë gjeti se fatura në fjalë buron nga kontrata me nr. të identifikimit 62500-19 067-511 e datës 30.09.2019 për asfaltimin e rrugëve në fshatrat e Malishevës Loto 1, ku palët, në kushtet e veçanta të kësaj kontrate, pika 21.1 janë pajtuar që debitori si operator ekonomik do bëj ndalesën e çmimit të kontratës prej 10% në emër të sigurimit të punimeve, ndërsa kjo pagesë do të realizohet tek autoriteti kontraktues, këtu kreditori pas pranimit përfundimtar të punimeve nga një komision i caktuar nga ZKA i debitorit. Në këtë drejtim, nga Raporti i pranimit teknik nr. prot. 05/465 e datës 15.10.2020, pjesë e shkresave të lëndës, vërtetohet se debitori ka formuar komisionin për pranim teknik të kontratës së lidhur mes palëve ndërgjyqëse, ashtu që komisioni ka vlerësuar se punimet nga kreditori janë kryer në mënyrë të plotë, dhe të njëjtat mund të pranohen teknikisht. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kërkesa që buron nga fatura nr. 12/20 e datës 02.11.2020 është bërë e arritshme, pasi që fatura në fjalë është lëshuar dhe kërkuar për pagesë vetëm pas pranimit teknik të punimeve, kjo në përputhje me kushtet e kontratës së palëve ndërgjyqëse. Fakti se pagesa e borxhit që rrjedh nga kjo faturë është bërë e arritshme, dhe se debitori ka qenë i njoftuar për detyrimin që rrjedh nga kjo faturë, nuk është kontestues as për vet debitorin, i cili në prapësimin e paraqitur, ka theksuar se faturën në fjalë e ka dërguar tek Thesari në Ministrinë e Financave për pagesë, por që e njëjta nuk është ekzekutuar.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura dokument i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin-faturat të cilat paraqesin dokumente të besueshme, pasi që të njëjtat janë të pranuar dhe nënshkruara nga ana e debitorit dhe si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit, për faktin se nga shkresat e lëndës respektivisht vërtetohet se kërkesa që buron nga fatura nr. 12/20 e datës 02.11.2020 është bërë e arritshme, pasi që fatura në fjalë është lëshuar dhe kërkuar për pagesë vetëm pas pranimit teknik të punimeve, kjo në përputhje me kushtet e kontratës së palëve ndërgjyqëse. Fakti se pagesa e borxhit që rrjedh nga kjo faturë është bërë e arritshme, dhe se debitori ka qenë i njoftuar për detyrimin që rrjedh nga kjo faturë, nuk është kontestues as për vet debitorin, i cili në prapësimin e paraqitur, ka theksuar se faturën në fjalë e ka dërguar tek Thesari në Ministrinë e Financave për pagesë, por që e njëjta nuk është ekzekutuar dhe fatura është si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi janë të

nënshkuara dhe pranuar nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht të njëjtat mund të konsiderohen si dokument i besueshëm për përmbartim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti kontraktual apo marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur mes tyre, ndërsa fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të përshtatshme për përmbartim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.Dh.Shk II.nr. 1417/23 me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**